



Republika e Kosovës
Republika Kosovo/ Republic of Kosovo

Prokurori i Shtetit / Državni Tužilac / State Prosecutor

Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit / Kancelarija Glavnog Državnog Tužioca /
Office of the Chief State Prosecutor



Raporti 24 orësh i Prokurorit të Shtetit

Prishtinë, 15 Tetor 2020 – Prokurori i Shtetit ju njofton se gjatë 24 orëve të fundit, nga prokuroritë themelore janë ngritur pesëdhjetedy (52) aktakuza, kundër shtatëdhjetedy (72) personave, për vepra të ndryshme penale, ndërsa, me urdhër të prokurorit të shtetit janë ndaluar dhjetë (10) persona të dyshuar.

Gjithashtu, janë paraqitur nëntë (9) kërkesa për caktimin e masës së paraburgimit, kundër njëmbëdhjetë (11) personave të dyshuar, për vepra të ndryshme penale.

Prokuroria Themelore në Prishtinë, me urdhër të prokurorit kujdestar, ka ndaluar tre (3) persona të dyshuar, ka paraqitur një (1) kërkesë për caktimin e masës së paraburgimit për një (1) person të dyshuar, një (1) kërkesë për caktimin e masës së arrestit shtëpiak për një (1) person, si dhe ka ngritur gjashtëmbëdhjetë (16) aktakuza kundër njëzetetë (23) personave, për vepra të ndryshme penale.

Prokuroria Themelore në Prizren, ka ndaluar një (1) person për 48 orë, ka bërë dy (2) kërkesa për caktimin e paraburgimit për dy (2) persona dhe ka ngritur gjashtë (6) aktakuza, kundër tetë (8) personave, për kryerjen e veprave të ndryshme penale, të përcaktuara në Kodin Penal të Republikës së Kosovës (KPRK).

Prokuroria Themelore në Pejë, ka bërë një (1) kërkesë për caktimin e masës së paraburgimit, kundër një (1) të pandehuri dhe ngritur dy (2) aktakuza, kundër dy (2) personave, për vepra të ndryshme penale.

1. Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës

////////

2. Prokuroria Themelore Prishtinë

Ndalimet e personave me urdhër të prokurorit:

Prokuroria Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm, me urdhër të prokurorit kujdestar, ka ndaluar një (1) person, pasi i njëjti dyshohet se ka kryer veprën penale “Lëndimi trupor” dhe dy (2) persona me dyshimin se kanë kryer veprën penale “Dhuna në familje”.

Kërkesat për caktimin e paraburgimit (apo masa tjera):

Departamenti i Përgjithshëm, ka paraqitur një (1) kërkesë për caktimin e masës së paraburgimit për një (1) person, për veprën penale “Kanosja” dhe një (1) kërkesë për caktimin e masës së arrestit shtëpiak për një (1) person, për veprën penale “Ngacmimi”.

Aktakuzat:

Gjatë 24 orëve të fundit, Prokuroria Themelore në Prishtinë, ka ngritur gjashtëmbëdhjetë (16) aktakuza, kundër njëzetetre (23) personave, për këto vepra penale:

Tri (3) aktakuza kundër katër (4) personave për veprën penale “Sulmi”,

Dy (2) aktakuza kundër katër (4) personave për veprën penale “Vjedhja e rëndë”,

Një (1) aktakuzë kundër tre (3) personave për veprën penale “Lidhja e paautorizuar në shërbime”,

Një (1) aktakuzë kundër dy (2) personave për veprën penale “Asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë”,

Një (1) aktakuzë kundër dy (2) personave për veprën penale “Lëndimi i rëndë trupor”,

Një (1) aktakuzë kundër një (1) personi për veprën penale “Lëndimi i lehtë trupor”,

Një (1) aktakuzë kundër një (1) personi për veprën penale “Kanosja”,

Një (1) aktakuzë kundër një (1) personi për veprën penale “Vjedhja e pyllit”,

Një (1) aktakuzë kundër një (1) personi për veprën penale “Cenimi i paprekshmërisë së banesave dhe objekteve”,
Një (1) aktakuzë kundër një (1) personi për veprën penale “Shmangia nga pagesa e tarifave të detyrueshme doganore”,
Një (1) aktakuzë kundër një (1) personi për veprën penale “Ngasja në gjendje të paaftë apo të dehur”,
Një (1) aktakuzë kundër një (1) personi për veprën penale “Posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge”,
Një (1) aktakuzë kundër një (1) personi për veprën penale “Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve”.

3. Prokuroria Themelore Prizren

Ndalimet e personave me urdhër të prokurorit:

Departamenti për Krime të Rënda ka ndaluar një (1) person për 48 orë, nën dyshimin se i njëjti ka kryer veprat penale “Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve” dhe “Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm”.

Kërkesat për caktimin e paraburgimit (apo masa tjera):

Departamenti i Përgjithshëm ka bërë një (1) kërkesë për caktimin e paraburgimit për një (1) person, nën dyshimin e bazuar se i njëjti ka kryer veprën penale “Kalimi i paautorizuar i vendkalimeve kufitare ose i vijës kufitare” dhe një (1) kërkesë për paraburgim për një (1) person, nën dyshimin se i njëjti ka kryer veprën penale “Lëndimi i lehtë trupor”.

Aktakuzat:

Gjatë 24 orëve të fundit, Prokuroria Themelore në Prizren, Departamenti Përgjithshëm, ka ngritur gjashtë (6) aktakuza, kundër tetë (8) personave, për këto vepra penale:

Dy (2) aktakuza kundër katër (4) personave për veprën penale “Lëndimi i lehtë trupor”,

Një (1) aktakuzë kundër një (1) personi për veprën penale “Kalimi i paautorizuar i vendkalimeve kufitare ose i vijës kufitare”,

Një (1) aktakuzë kundër një (1) personi për veprën penale “Dhuna në familje”,

Një (1) aktakuzë kundër një (1) personi për veprën penale “Dëmtimi, shkatërrimi dhe nxjerrja e paautorizuar e monumenteve ose objekteve të mbrojtura jashtë Republikës së Kosovës”,

Një (1) aktakuzë kundër një (1) personi për veprën penale “Kanosja”.

4. Prokuroria Themelore Pejë

Kërkesat për caktimin e paraburgimit (apo masa tjera):

Prokuroria Themelore e Pejës, gjatë 24 orëve të fundit ka bërë një (1) kërkesë për caktimin e masës së paraburgimit, kundër një (1) të pandehuri për veprat penale "Dhuna në familje" dhe "Kanosje".

Aktakuzat:

Prokuroria Themelore në Pejë, ka ngritur dy (2) aktakuza, kundër dy (2) personave, për këto vepra penale:

Një (1) aktakuzë kundër një (1) personi për veprën penale "Sulmi",

Një (1) aktakuzë kundër një (1) personi për veprën penale "Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve".

5. Prokuroria Themelore Gjilan

Ndalimet e personave me urdhër të prokurorit:

Prokuroria Themelore në Gjilan, me urdhër të prokurorit, ka ndaluar katër (4) persona të dyshuar, në kohëzgjatje prej 48 orëve. Një (1) person është ndaluar për shkak të dyshimit të bazuar se ka kryer veprat penale "Ndërprerja e palejuar e shtatzënisë" dhe "Moslajmërimi i veprave penale dhe kryesve të tyre", një (1) person është ndaluar për shkak të dyshimit të bazuar se kanë kryer veprat penale "Organizimi i skemave piramidale dhe bixhozit të paligjshëm", një (1) person është ndaluar me dyshimin se ka kryer veprën penale "Blerja, pranimi ose fshehja e sendeve të përfituara me kryerjen e veprës penale" dhe një (1) person për veprën penale "Lëndimi i lehtë trupor".

Kërkesat për caktimin e paraburgimit (apo masa tjera):

Prokuroria Themelore në Gjilan ka paraqitur një (1) kërkesë për caktimin e masës së paraburgimit, ndaj një (1) personi, për shkak të dyshimit të bazuar se ka kryer veprën penale "Blerja, pranimi ose fshehja e sendeve të përfituara me kryerjen e veprës penale", një (1) kërkesë për paraburgim ndaj një (1) personi, për veprën penale "Organizimi i skemave piramidale dhe bixhozit të paligjshëm" dhe një (1) kërkesë për paraburgim ndaj një personi, me dyshimin se ka kryer veprën penale "Lëndimi i lehtë trupor".

Aktakuzat:

Prokuroria Themelore në Gjiilan, ka ngritur tetë (8) aktakuza, kundër nëntë (9) personave, për këto vepra penale:

Tri (3) aktakuza kundër tre (3) personave për veprën penale "Vjedhja e pyllit",

Një (1) aktakuzë kundër dy (2) personave për veprën penale "Organizimi i skemave piramidale dhe bixhozit të paligjshëm",

Një (1) aktakuzë kundër një (1) personi për veprat penale "Lëndimi i lehtë trupor" dhe "Ngacmimi",

Një (1) aktakuzë kundër një (1) personi për veprën penale "Rrezikimi i trafikut publik",

Një (1) aktakuzë kundër një (1) personi për veprën penale "Ndotja, degradimi ose shkatërrimi i ambientit",

Një (1) aktakuzë kundër një (1) personi për veprën penale "Dhunimi".

6. Prokuroria Themelore Gjakovë

Ndalimet e personave me urdhër të prokurorit:

Gjatë 24 orëve të fundit, me urdhër të prokurorit kujdestar, në Prokurorinë Themelore në Gjakovë, nga Departamenti i Përgjithshëm është ndaluar një (1) person në kohëzgjatje prej 48 orësh, për shkak të dyshimit të bazuar se ka kryer veprën penale "Dhuna në familje".

Kërkesat për caktimin e paraburgimit (apo masa tjera):

Prokuroria Themelore në Gjakovë, Departamenti Përgjithshëm, ka bërë një (1) kërkesë për caktimin e masës së paraburgimit kundër tre (3) personave, për shkak të dyshimit të bazuar se kanë kryer veprën penale "Dhuna në Familje".

7. Prokuroria Themelore Mitrovicë

Aktakuzat:

Prokuroria Themelore në Mitrovicë, ka ngritur katërmbëdhjetë (14) aktakuza, kundër gjashtëmbëdhjetë (16) personave, për këto vepra penale:

Katër (4) aktakuza kundër katër (4) personave për veprën penale “Vjedhja e shërbimeve”,

Dy (2) aktakuza kundër dy (2) personave për veprën penale “Posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge”,

Një (1) aktakuzë kundër tre (3) personave për veprën penale “Vjedhja”,

Një (1) aktakuzë kundër një (1) personi për veprën penale “Keqtrajtimi i kafshëve dhe ndotja e ushqimit dhe e ujit të shtazëve”,

Një (1) aktakuzë kundër një (1) personi për veprën penale “Ngasja në gjendje të paaftë apo të dehur”,

Një (1) aktakuzë kundër një (1) personi për veprën penale “Falsifikimi i dokumenteve”,

Një (1) aktakuzë kundër një (1) personi për veprën penale “Kontrabandimi i mallrave”,

Një (1) aktakuzë kundër një (1) personi për veprën penale “Lëndimi i lehtë trupor”,

Një (1) aktakuzë kundër një (1) personi për veprën penale “Vjedhje pylli”,

Një (1) aktakuzë kundër një (1) personi për veprën penale “Ngacmimi”.

8. Prokuroria Themelore Ferizaj

Ndalimet e personave me urdhër të prokurorit:

Prokuroria Themelore në Ferizaj, Departamenti i Përgjithshëm, me urdhër të prokurorit kujdestar, ka ndaluar në kohëzgjatje prej 48 orësh, një (1) person, nën dyshimin se i njëjti ka kryer veprën penale “Dhuna në familje”

Aktakuzat:

Prokuroria Themelore në Ferizaj, gjatë 24 orëve të fundit, ka ngritur gjashtë (6) aktakuza, kundër katërmbëdhjetë (14) personave, për këto vepra penale:

Një (1) aktakuzë kundër gjashtë (6) personave për veprën penale “Vjedhje”,

Një (1) aktakuzë kundër katër (4) personave për veprën penale “Lëndim i rëndë trupor”,

Një (1) aktakuzë kundër një (1) personi për veprat penale “Posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge” dhe “Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve”,

Një (1) aktakuzë kundër një (1) personi për veprën penale “Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve”,

Një (1) aktakuzë kundër një (1) personi për veprën penale “Lajmërimi apo kallëzimi i rremë”,

Një (1) aktakuzë kundër një (1) personi për veprën penale “Dhuna në familje” .